BASHKIA SARANDE

PROJEKT DOKUMENTI I

PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2027 - 2029

Sarande, Shtator 2026

SHPENZIMET NË NIVEL PROGRAMI, DHE NIVELI I TE ARDHURAVE TE PBA 2027-2029

Procesi i hartimit te Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për, "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor, Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" te Udhezimit nr 7 date 27.02.2026, dhe Udhezimit plotesues nr. 17 date 10.07.2026 "Per pregatitjen e PBA 2027-2029", u parashikua nivelin i të ardhurave dhe tavanet e shpenzimeve publike, në nivel programi, për periudhën afatmesme.

Keshilli Bashkiak me Vendim Nr.151. date 23.12.2025 "Per miratimin e buxhetit afat mesem 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit te vitit 2026" ka miratuar edhe kalendarin e pergatitjes se PBA 2027-2029.

Formatet e perdorura per miratimin e PBA jane konform kerkesave ligjore per planifikimin buxhetor, duke perfshire elementet e nevojshem si pema e programeve, qellimet ,objektivat pema e produkteve, klasifikimi ekonomik, etj., pjese e Sistemit te Menaxhimit Buxhetor Vendor (SMBV) si nje aplikacion i mbeshtetur ne baze te dhenash, i cili do te lehtesoje dhe do te siguroje gjithperfshirjen e te gjitha paleve pergjegjese ne pergatitjen e PBA 2027-2029 nga formatet elektronike prej te cilit varet edhe hartimi teknik i PBA.

Udhezimi standart i hartimit PBA perfshin;

a) Rolet dhe pergjegjesite per Kryetarin e NJQV-se ,Keshillin e NJQV-se, GMS, Drejtuesir dhe anetareve te EMP-ve si edhe MF-se,.
b) Procedurat,fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjine per programin dhe buxhetimin.
c) Kerkesat e raportimit te PBA; Misionin e Njesise te vetqeverisjes vendore dhe trukturen e programeve; Deklaraten e politikes se programeve, Tavanet e NjVQV; Shpenzimet e progameve;Shpenzimet e programeve sipas produkteve;; Projektet me financim te brendshem.

Udhezimi vjetor i PBA -se, percakton kerkesat specifike per procesin e PBA-se te NJQV , duke perfshire edhe kerkesa te vecanta per hartimin e praogramit buxhetor afatmesem.

a) Afatet per pergatitjen e dokumentit te PBA-se dhe Informacionin mbi transferten e pakushtezuarte pergjithshme dhe ate sektoriale per periudhen afatmesme.
b) Procesin e pergatitjes se PBA, Hartimi i tavaneve Buxhetore te PBA -se ; Organizimit te procesit; Pemes se programeve, Draft dokumentin e PBA -se

c) Dokumenti i PBA -se eshte pergatitut nepermjet Sistemit te Menaxhimit Te Buxhetit Vendor (SMBV). Nga MFE eshte vene ne dispozicion nje llogari perdoruesi per sekretarin e GMS -Se (Nepunesi Zbatues), dhe nepermjet tij krijohen llogarite e anetareve te tjere te stafit te Bashkise bazuar ne rolet e tyre ne hartimin e Buxhetit vjetor.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

1. Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent thelbesor i planifikimit buxhetor ne nilev kombëtar dhe vendor.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin **mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej** dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e

nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë **për planifikimin e investimeve publike** sipas programeve buxhetore duke përfshirë **edhe kërkesat për shpenzimet korente**. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në parashikimin e treguesave të rëndësishëm të Programit Buxhetor AM 2027-2029, Grupi i menaxhimit Strategjik u mbështet në infrastrukturën ligjore e n/ligjore përkatëse të MFE në metodologjinë e planifikimit prognozë si dhe në ecurinë e realizimin faktik gjatë periudhës 2023-2025. Përcaktimi i nivelit të të ardhurave sipas zërave e burimeve të krijimit si dhe i **tavaneve limit të shpenzimeve publike në nivel programi**, përbëjnë domosdoshmëri për një zhvillim të qëndrueshëm afat-mesëm vendor**.**

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Ne Programin Buxhetor Afatmesem(PBA) perfshihen:

a. Aparati i Bashkise Sarande
b. Njesite e Varesise

PBA-ja eshte hartuar ne baze te funksioneve, ku cdo funksion ledhet me disa programe te pushtetit vendor, brenda te cilave jane perfshire nje ose me shume Njesi Shpenzuese, ne perputhje me funksionet dhe qellimet perkatese per cdo njesi.

Per cdo program jane parashikuar te gjitha shpenzimet qe do te sherbejne per realizimin e objektivave te tij, sipas lloit dhe Njesive Shpenzuese.

Shpenzimet e buxhetit te Bashkise Sarande sipas natyres jane:

a. Shpenzime personeli
b. Shpenzime operative
c. Shpenzime kapitale
d. Fondi Rezerve dhe kontigjences

2. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029

Objektivi i politikave afat mesme te Bashkise Sarande eshte zhvillimi i qëndrueshëm, qe e pare nga këndvështrimi i këtij dokumenti është projektuar si një qasje e sistemit aktual vendor drejt rritjes dhe zhvillimit urban dhe rural, duke siguruar një manaxhim të suksesshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.

Vizioni ynë për tre vitet e ardhshme projekton Saranden si një qytet te aksesueshëm falë përmirësimit të infrastrukturës publike; një qytet që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur ekuilibrat mes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social, mbrojtjes së mjedisit; një qytet gjithëpërfshirës që ka si prioritet ndërtimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e pjesëmarrjen e të rinjve dhe që garanton mbrojtje dhe përkujdesje për grupet në nevojë.

Objektivat per projekte madhore ne 3 vejcarin e ardhshem;

- **Ndertimi i rruges se gjashte**, aktualisht ne perfundim te fazes se projektimit eshte nje projekt madhor ,duke i dhene nje dimension tjeter aksesit ne Sarande, per te lehtesuar levizshmerine, dhe zhvillimin e sigurt ekonomik te qytetit dhe jo vetem. Ky projekt synon te lehtesoje levizjen ne hyrje dhe dale te Sarandes kryesisht ne sezonin veror, duke u bere nje porte tjeter dytesore ne veri – perendim. Ne projekt perfshihet edhe nje tunel qe do te lidhe rrugen e bregdetit jugor me Saranden , ne menyren per panoramike te mundshme ne funksion te turizmit dhe ekonomise vendore.
- **Ndertimi i shetitores ne Ksamil**, eshte nje projekt tjeter madhor ne 3 vitet e ardhshme , ne funksion te turizmit dhe ekonomise te qendrueshme te asaj zone dhe jo vetem. Shetitorja do te jete e aksesueshme nga qytetaret pergjate vijes bregdetare dhe do jete nje vlere e shtuar per turizmin. Nje projekt i tille eshte shume i vlefshem per nje vend i shumefrekuentuar nga turistet. Njekohesisht do te sherbeje edhe si nje zone relaksimi per vizitoret.
- **Ndertimi nje qendre mikpritje ne Ksamil** me Terrene sportive, sherbimi dhe argetimi, do jete nje tjeter projekt me impakt te ndjeshem ne zonen turistike te Ksamilit. Mungesa e terreneve sportive e ben shume te nevojshme nje projekt te ri bashkohor ne funksion te rinise qe frekuenton Ksamilin si zone turistike.
- **Rikualifikim te Ures se Metoqit,** eshte nje projekt tjeter shume i domosdoshem per ate zone e cila do jete ne funksion te fermereve dhe zhvillimit te Bujqesise.

- **Rikualifikim te Rruges Turizem Kanal i Cukes,** do te jete nje projekt tjeter qe do te zbatohet ne nje nder rruget me kryesore te qytetit. Investimi ne kete rruge eshte nje domosdoshmeri qe vjen nga zhvillimi i vazhdueshem dhe zgjerimi i zones ekonomike qe akseson ate rruge.
- **Rikonstruksioni i shkollave dhe kopeshteve te pa rikonstruktuara ne vitete e fundit.** Ky projekt ka per qellim rikualifikimin e mjediseve shkollore dhe pershtatja me kushtet bashkohore qe kerkon mesimdhenia ne te gjitha institucionet arsimore te Bashkise se Sarandes
- **Rikonstruksioni i shtepise se femijes,** eshte nje tjeter projekt ne zbatim dhe nje domosdoshmeri, per krijimin e nje mjedisi te pershtatshm per femijet qe jetojne ne ate institucion, dinjitoz dhe bashkohor. Projekti ka filluar zbatimin dhe njekohesisht bashkia do te investoje edhe ne mjediset perreth ne rikonstruksionin e kopeshtit qe eshte prane asaj godine dhe jo vetem, duke kthyer sipefaqen perreth ne nje zone relaksuese si dhe kend lojrash per femije.

3. Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029

- ✓ Percaktimi i objektivave, nepermjet Planeve zhvilluese strategjike.
- ✓ Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë së Sarandes, dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- ✓ Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të

  planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
- ✓ Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;

4. Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet dhe objektivat për çdo program.

PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë duke u fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave prioritare te komunitetit te ndërthurura me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese;

Shpenzimet:

a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes)
b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Sarandës
b. Institucionet e varësisë

Për ti paraprirë gjithë proçesit zhvillues trivjeçar 2027-2029, paraprakisht parashikohen e miratohen nivelin e te ardhurave vendore dhe tavanet e shpenzimeve buxhetore në nivel programi. Kjo bën të domosdoshëm dhe kërkon nevojën e kostimit të politikave zhvilluese sipas sektorëve e fushave të veprimtarisë vendore.
Tavanet e shpenzimeve publike hartohen mbi bazën e historikut dhe të analizës të ecurisë së shpenzimeve faktike në periudhen trevjecare. Në gjithë këtë proçes merr rëndësi të veçantë **përcaktimi i drejtë i burimeve** vendore nga taksat dhe tarifast vendore, si edhe atyre të mbështetura nga burimet qëndrore e alternative.
Në qendër të PBA-së janë dy procese; (i) planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe (ii)shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

A. PARASHIKIMI I TE ARDHURAVE E PERGJITHSHME TE BASHKISE SARANDE PER PBA 2027-2029

Legjistacioni mbi te cilin eshte mbeshtetur hartimi i parashikimit afatmeset te te ardhurave 2027-2029;

a. Ligji 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave Vendore" i ndryshuar
b. Ligji 9920 date 26.05.2008 "Per procedurat tatimore ne republiken e Shqiperise" i ndryshuar,
c. Ligji 9936 date 26.06.2008 "Per Me naxhimin e sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise"
d. Ligji 9975 date 28.072008, Per taksat kombetare" i ndryshuar
e. Ligji 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore"
f. Ligji 68/2017, date 24.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore"
g. Vendimi nr 142 date 27.11.2025 te Keshillit Bashkiak " Mbi nivelin e Taksave dhe Tarifave Vendore per Bashkine e Sarandes".

Përcaktimi real i kapaciteteve të burimeve vendore shërben për të projektuar sa më drejt potencialet zhvilluese afatmesëm, të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kjo na mundëson hapa të sigurtë e të qëndrueshëm për hartimin e një programi real zhvillimi, i cili do të garantojë zgjerimin dhe rritjen e efiçencës së përdorimit të inputeve vendore.
Metoda e parashikimit te nivelit te te ardhurave ne planin afatmesem jane bazuar ne:

a. Trendi i realizimit te te ardhurave ne 3 vitet e fundit.

b. Zgjerimi i bazes se kapaciteteve fiskale bazuar ne politikat makroekonomike dhe vendore per orjentimin e zhvillimit ekonomik.
c. Parashikimi i ecurise se kapaciteteve fiskale per tarifat e perkohshme bazuar ne zbatimin e PPV.

Parashikimi afatmesem i te ardhurave behet;

a) dy vitet para vitit buxhetor
b) vitin buxhetor
c) tre vitet e ardhshme buxhetore

Metodologjia e perdorur per parashikimet afatmesme te te ardhurave;

Parashikimi i te ardhurave eshte mbeshtetur ne ecurine e realizimit te tyre ne vitet e meparshme si edhe politikat e percaktuara ne periudhen ne vijim;

Ndryshimet kryesore vijne si pasoje e ndryshimeve te:

- Ndryshime te lidhura si pasoje e realizimit faktik dhe parashikimi i shlyerjes se detyrimeve te prapambetura
- Hartimi i planit per mbledhjet e detyrimeve te prapambetura ne lidhje me taksat dhe tarifat kryesore, pervec ngarkeses fiskale te viteve qe parashikohen.
- Parashikimi i zerave qe kane lidhje me taksat kombetare . Ne lidhje me parashikimine ketyre zerave bazohemi ne ecurine e realizimit te taksave ne dy vitet e funditperkundrejt planit.

Ecuria dhe ndryshimi i zerave te te ardhurave per bashkine Sarande per periudhen afatmesme jane si me poshte;

Tab.1

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Realizimi faktik	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
		Fakt v 2025	v 2026	v 2027	v 2028	v 2029
1	Te ardhurat e veta /TOTALI	873,929	923,469	1,290,581	1,253,846	1,274,882
a	**Te ardhura nga Taksat**	**615,882**	**635,602**	**987,516**	**938,890**	**947,965**
1	**Taksat vendore**	**562,705**	**580,078**	**934,271**	**880,990**	**884,991**
	Tatim thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	327	1,000	1,000	1,000	1,000
	Taksa mbi Ndërtesat	132,835	165,146	180,099	196,398	199,398
	Taksa mbi token bujqësore	4,588	6,000	6,000	6,000	6,000
	Taksa e fjetjes në hotel	112,398	78,200	110,000	111,000	112,000
	Taksa e ndikimit në infrastrukture	189,800	175,000	480,000	396,063	396,063
	Taksa për zënien e hapësirave publike	105,324	123,932	135,230	147,264	147,264
	Taksa e tabelës	1,600	2,500	2,500	2,500	2,500
	Taksa trualli	4,636	3,500	3,850	4,235	4,236
	Taksa për zënien e hap.publike për reklama	5,778	4,800	5,592	6,530	6,530
	Taksa e ndikimit në infrastrukture B.Sociale	5,419	20,000	10,000	10,000	10,000
2	**Taksat e ndara(grante)**	**53,177**	**55,524**	**53,245**	57,900	62,974
	Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise	5,830	14,500	6,000	6,000	6,000
	Taksa e mjeteve te perdorura	34,116	30,500	33,245	36,100	39,212
	Tatim mbi te ardhurat personale	13,231	10,524	14,000	14,000	14,000

b	**Të ardhura nga tarifat**	**225,060**	**252,967**	**267,815**	**279,206**	**291,166**
	Tarifa për pastrim + gjelberim	183,931	216,967	227,815	239,206	251,166
	Tarifa pyje-kullota, shërb.zjarrfikës,leje tran.	1,295	3,000	3,000	3,000	3,000
	Tarifa parkimi/transporti	15,601	12,000	13,500	13,500	13,500
	Tarife për shërbime te tjera administrative	24,233	21,000	23,500	23,500	23,500
c	**Të ardhura te tjera**	**32,987**	**34,900**	**35,250**	**35,750**	**35,751**
	Shitje Troje e pasuri	7,634	3,000	3,000	3,000	3,000
	Qera të aseteve vendore	5,764	6,300	6,300	6,300	6,300
	Te ardhura nga gjobat	8,654	7,500	8,000	8,000	8,000
	Tarife për shërbime sociale (arsim parash.çerdhe, konvikte)	10,065	9,000	9,000	9,500	9,501
	Sporte dhe kultura,muzeumet,	20	200	50	50	50
	Sponsorizime	770	8,000	8,000	8,000	8,000
	T'Ardhura nga vitet e kaluara	80	900	900	900	900
	Shuma	873,929	923,469	1,290,581	1,253,846	1,274,882
2	**Transfertat e pakushtezuara**	**462,527**	**494,503**	**515,123**	**533,384**	**552,248**
	Transferta e Pakushtëzuar	268,081	290,896	308,933	327,194	343,997
	Transferta e pakushtezuar sektoriale	149,246	162,607	165,190	165,190	167,251
	Transferta e pakushtezuar per mbetjet	45,200	41,000	41,000	41,000	41,000
	Shuma	**1,336,456**	**1,417,972**	**1,805,704**	**1,787,230**	**1,827,130**
3	Te ardhurat te trasheguara nga viti i kaluar	793,054	875,377	670,708	682,000	650,000
	Totali I te Ardhurave	2,129,510	2,293,349	2,476,412	2,469,230	2,477,130

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Nga analiza e strukturës së burimeve vendore arrihet në përfundim se të ardhurat nga taksat vendore zënë një peshë të konsiderueshme dhe përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave vendore ne rreth 69% te totalit. Në vitin 2026 niveli i të ardhurave nga taksat është parashikuar me rritje 6% krahasimisht me nje vit me pare, dhe per periudhen afat mesme eshte parashikuar me rritje 16%.Pas nje periudhe tre vjecare me rritje te konsiderueshme te te ardhurave nga taksat dhe tarifat, parashikohet nje stabilitet fiskal per Bashkine me nje rritje te moderuar nga viti ne vit.

Parashikimi ne rritje ka ne vemendje realizimin faktik 2025, trendin e rritjes se te ardhurave ne periudhe afat mesme, dhe treguesit e bazes se taksueshme kryesisht per;

- Siperfaqen e truallit per ndertim
- Numri i bizneseve aktive
- Numri i lejeve te ndertimit
- Numri i shtreterve ne hotel
- Numri i vizitoreve vendas dhe te huaj per nje nate

Ecuria e realizimit te taksave paraqiten ne tabelen e meposhtme;

Taksat Vendore					
Periudha kohore	Fakt 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
Taksat Vendore	615,882	635,602	987,516	938,890	947,965



Taksa mbi ndertesat mesatarisht ze rreth 27% te totalit te taksave dhe parashikimi afatmesem ne buxhet eshte rreth 21% me i larte krahasimisht me buxhetin e vitit aktual. Rritja e parashikuar i referohet rritjes se numrit te lejeve te ndertimit duke cuar ne rritjen e bazes se taksueshme, siperaqes se ndertimit per shtepi banimi dhe biznese si edhe saktesimi ne vazhdimesi i te dhenave baze per perllogaritjen e kapacitetit fiskal, nepermjet metodave te ndryshme si ajo e kadastres fiskale etj.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture eshte taksa e dyte per nga ndikimi ne buxhetin vendor dhe ze mesatarisht 31% te te ardhurave nga taksat e bashkise. Planifikimi i te ardhurave nga kjo takse eshte ne rritje ne reference te realizimit faktik ne periudhe afatmesme, ndryshimeve ne paketen fiskale te nivelit te takses sipas kategorive dhe prognozes se zhvillimit territorial ne Bashkine e Sarandes.

Taksa e fjetjes ne hotel eshte gjithashtu takse premtuese per te ardhurat e Bashkise me rreth 15% te totalit te taksave. Ritja e parashikuar ne programin afatmesem eshte me rreth 43 % ne rritje. Ritja e parashikimit eshte bere ne baze te te dhenave per rritjen e njesive akomoduese ne Sarande dhe Ksamil, formalizimin e bizneseve qe operojne ne territorin e bashkise, forcimin e disiplines administrative si edhe ndryshimet ne paketen fiskale 2024 te nivelit te takse.

Taksa e zenies se hapesires publike perben mesatarisht 20% te totalit te buxhetit nga taksat vendore. Perbehet kryesisht nga dhenia ne perdorim e hapesirave publike ne periudhe sezonale , dhe tarifat per siperfaqet e plazheve. Ne periudhen afat mesme parashikohet ne rritje me 19%.
Rritja i referohet rritjes se bazes se takses si edhe kerkesave ne rritje per siperfaqe publike ne perdorim, kryesisht ne sezonin e veres.

Taksa e zenies se hapesires publike me reklama, ze rreth 2% te taksave dhe parashikimi per periudhen afatmesme eshte ne te njejtat nivele me periudhen aktuale.

A. 2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe taksa e kalimit te se drejtes se pronesise.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera. Per periudhen afat mesme eshte parashikuar me 33% ne rritje, duke ju referuar realizimit faktik 2025.


Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë. Ne kategorine e taksave te ndara zene 56% te totalit. Ne buxhetin afatmesem eshte parashikuar ne rritje me 29% ne raport me vitin korent ne reference te realizimit faktik per vitin 2025.

Taksa e kalimit te se drejtes se pasurise

Te ardhurat nga kjo takse perfshijne taksen qe perfiton bashkia ne momentin e kalimit te prones te pronari nepermjet ASHK. Per periudhen afatmesme eshte parashikuar pothuajse ne te njejtat nivele ne strukturen e taksave te ndara.
Ecuria e realizimit te taksave te ndara paraqitet si me poshte;

Taksat Vendore						
Periudha kohore	Fakt 2024	Fakt 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
Taksat e ndara	50,194	53,177	55,524	53,245	57,900	62,974



A.3 Tarifat vendore.

Te ardhurat nga tarifat vendore zene 27% te totalit te te te ardhurave te veta te Bashkise. Rritja e tarifave ne periudhe afatemesme eshte parashikuar ne nivelin 15%. Ndikimin me te madh ne rritjen e nivelit te te ardhurave ne buxhet e ka tarifa e sherbimeve publike nepermjet rritjes se nivelit te tarifave ne paketen fiskale 2024 shoqeruar nga rritja e bazes se taksueshme.

Në te ardhurat nga tarifat vendore, siç pasqyrohet në tabelën përkatëset, peshën kryesore e zënë te ardhurat nga **tarifa e shërbimeve publike**, me rreth 80% e totalit për pastrimin, gjelberimin dhe ndriçimin.

Tarifat Vendore						
Periudha kohore	Fakt 2024	Fakt 2025	Parashik 2026	Parashik 2027	Parashik 2028	Parashik 2029
Tarifat Vendore	177,805	225,060	252,967	267,815	279,206	291,166

Tarifa e menaxhimit te mbetjeve urbane

Tarifa e Pastrimit eshte tarifa me peshe me te madhe ne strukturen e tarifave vendore me rreth 86% te totalit te tarifave vendore. Kesaj tarife i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Sarandes. Parashikimi ne periudhen afatmesme 2027-2029 ne rritje me rreth 16% eshte bere duke u referuar rritjes se pritshme te bazes se taksueshme.

Tarifa për shërbime te tjera administrative

Kategoria e Tarifave te vendosur per sherbime te tjera administrative, perfshin sherbimet e dhena nga Bashkia me pagese, qerate nga asatet e bashkise, gjobat, pagesa nga kopeshte dhe cerdheve, bileta , sponsorizime, etj. Te ardhurat nga kjo kategori perbejne 8% te totalit te te ardhurave nga tarifat, nderkohe qe parashikimi afatmesem eshte me 12% ne rritje.

A.4 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Per periudhen afatmesme parashikimi i ne buxhet eshte ne rritje me rreth 23%, ne reference te prognozesse alokimit te transfertes.

Emertimi	Fakt 2024	Plan 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
Transferta e pakushtezuar	180,074	268,081	290,896	308,933	327,194	343,997
Ndryshimi ne %		149%	108%	106%	106%	106%


A.5 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe Udhëzimit Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" financohen nëpërmjet transfertës se pakushtezuar sektoriale. Programet e financuara nga kjo transferte jane:

- Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor
- Personeli mbështetës i arsimit para-universitar
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri
- Shërbimi pyjor
- Ujitja dhe kullimi
- Mbrojtja civile

Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtezuar sektoriale për Bashkinë e Sarandes në periudhën afat mesme paraqitet si vijon;

Emertimi	Fakt 2024	Plan 2025	Parashi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
Transferta e pakushtezuar sektoriale	122,843	149,246	162,607	165,190	165,190	167,251
Ndryshimi ne %		108%	161%	100%	100%	100%



B. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE TE BASHKISE SARANDE PER PBA 2027-2029

Per shpërndarjen e burimeve **dhe përcaktimin e tavaneve buxhetore per cdo program buxhetore GMS eshte bazuar në** realizimin faktik te viteve 2024-2025. Parashikimi i fondeve buxhetore mbështet kryesisht në burimet e brendshme te bashkise . Percaktimi i drejtë i burimeve vendore dhe i atyre alternative kushtëzojnë edhe kapacitetet zhvilluese vendore për periudhën afatmesme 2027-2029. Përditësimi i burimeve imponojne gjithashtu edhe përditësimin **e tavaneve të shpenzimeve** publike në nivel programi.

Pjese e burimeve është jane edhe fondet pa perdorura, që do të mbartet nga viti ne vit. Fondet e mbartura përbëjnë fondet e papërdorura në vitin respektiv, ku përfshihen të ardhurat nga dy burime financimi, të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Sarandes për vitet 2027-2029, parashikohen të ndara sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike si me poshte:

Tavanet e Shpenzimeve te Bashkise Sarande sipas llogarive ekonomike 2027-2029;

Kategoria e Shpenzimeve	Ralizimi dhe parashikimi Afat mesem i shpenzimeve					
	F 2024	F 2025	P 2026	P 2027	P 2028	P 2029
Shpenzime personeli	396,830	486,428	606,104	627,198	627,198	633,470
Shpezime të tjera korente	402,678	438,036	557,084	566,838	574,074	574,074
Shpenzime për Investime Kapitale	182,577	334,033	1,130,161	1,282,376	1,267,958	1,269,586
TOTALI	982,085	1,258,497	2,293,349	2,476,412	2,469,230	2,477,130



Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik;

Parashikimi i fondeve buxhetore behet ne baze te klasifikimit ekonomik :

1. **Shpenzimet e personelit** per administraten, punonjesit mbeshtetes dhe punonjesit me kontrate te njesivete aparatit te bashkise dhe njesive ne varesi dhe ze mesatarisht rreth **31%** te totalit te buxhetit per periudhen afatmesme me nje rritje rreth 5.8% deri ne 2028.
   Ne tabelen e meposhtme pasqyrohen **shpenzimet e personelit per vitet 2025-2029;**

nr	Funksionet	Fakt 2025	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	214,043	248,462	264,327	264,327	266,970
3280	Shërbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	23,658	20,937	26,590	26,590	26,856
4240	Ujitja dhe kullimi,bujqesia	2,099	2,276	2,707	2,707	2,734

4260	Administrimi Pyjeve	3,152	3,152	3,828	3,828	3,866
4520	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor	0	-	0	0	-
5100	Menaxhimi I Mbetjeve	0	-	0	0	-
6260	Sherbime Publike Vendore	93,257	100,362	121,062	121,062	122,273
6370	Ujesjelles, Kanalizime	0	-	0	0	-
8130	Programe Kulturale & Sporti	28,800	28,800	31,438	31,438	31,752
9120	Arsimi parashkollor	104,793	117,284	129,984	129,984	131,284
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	3,006	4,468	4,434	4,434	4,478
9230	Arsimi i mesem profesional	10,215	10,573	12,800	12,800	12,928
10430	Shërbimi Social & ndihma ekon.t'ardh veta	3,405	3,443	3,943	3,943	3,982
Totali		486,428	539,757	601,113	601,113	607,124

2. Shpenzimet korente, operative e të mirëmbajtjes sipas programeve**,** është projektuar me rritje progresive kryesisht ne programin e sherbimeve publike arsim , mbrojtje nga zjarri, bujqesi, projekte kulturore, sport etj. Ne total fondi per shpenzimet korrente ne vitin 2029 eshte parashikuar me 4% rritje krahasimisht me realizimin e buxhetit vjetor 2026.

Ne vemendje eshte mbështetja e politikave sociale e përmirësimin e raporteve të barazisë gjinore, për zhvillimin e arsimit, kulturës, sportit etj. Synimi në angazhimin e kryerjen e shpenzimeve publike për periudhën afatmesme 2027-2029 mbetet rritja e efiçencës dhe efektivitetit të përdorimit të tyre. Në programet e njësitë shpenzuese vendore, niveli i shpenzimeve korente, është parashikuar në limite të kontrolluara. Në strukturën e shpenzimeve publike, në vitin 2029, ato përbëjnë 28 % të shpenzimeve korente gjithësej. Rritja e fondeve ne dispozicion është një garanci për cilësi e standart jetese më të rritur cilesisht në vitet që vijnë, për rritje të akcesit të banorëve ndaj shërbimeve publike si dhe, të shërbimeve në sektorët social të arsimit, kulturës, etj. Nga analiza e strukturës së fondeve të angazhuara në nivel programi ka balanca të qëndrueshme e akses në rritje të banorëve ne shërbimet publike.

Ne tabelen e meposhtme pasqyrohen **shpenzimet operative per vitet 2027-2029;**

Kod Programi	Funksionet	Fakt 2025	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	168,146	237,428	242,177	247,020	247,020
3280	Shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit	4,261	3,270	3,335	3,402	3,402
4240	Ujitja dhe kullimi,bujqesia	2,000	5,291	5,397	5,505	5,505
4260	Administrimi Pyjeve		164	167	171	171
4520	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor			-	-	-
5100	Menaxhimi I Mbetjeve	193,471	201,024	205,044	205,044	205,044
6260	Sherbime Publike Vendore	36,525	55,580	56,692	57,825	57,825
6370	Ujesjelles, Kanalizime			-	-	-
8130	Programe Kulturale & Sporti	7,648	8,980	9,160	9,343	9,343
9120	Arsimi parashkollor	22,716	30,490	31,100	31,722	31,722
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	657	2,833	2,890	2,947	2,947
9230	Arsimi i mesem profesional	1,949	10,324	9,143	9,326	9,326
10430	Shërbimi Social t'ardh veta	663	1,700	1,734	1,769	1,769
Totali		438,036	557,084	566,838	574,074	574,074

3. Shpenzimet Kapitale

Parashikimi i shpenzimeve afat mesme per investime kapitale nga te ardhurat e veta te bashkise eshte parashikuarme rritje ne nivelin e 22%. Ne strukturen e buxhetit Investimet publike zene mesarisht 41% te totalit te buxhetit, me financim nga te ardhurat e Bashkise. Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 si i vetmi instrument për realizimin e Planit te Përgjithshmëm Vendor ka nxitur Bashkinë, që të kryej një llogaritje të mirë midis angazhimeve afatgjata dhe mundësive afatmesme, për të krijuar mundësinë e zhvillimit te territorit sipas PPV, dhe për të mënjanuar çekuilibrat fiskal. Bazuar në objektivat afatmesme të bashkisë dhe potencialin fiskal janë parashikuar zhvillimi i projekteve të investimeve prioritare.
Per përmirësimin e cilësisë së jeteses dhe shërbimeve publike si edhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm në te gjithë teritorin e bashkisë jane vendosur prioritetet në parashikimin projekteve për investime. Me prioritare jane vazhdimi i investimeve në proces, zhvillimi i projekteve me impakte të ndjeshme ne ekonomi dhe turizem, sic jane projektet ne rruge, ujesjelles,kulture e arsim.

Investimet me financim nga te ardhurat e veta jane ne rritje me rreth 22% ne periudhen afat mesme;

- Per vitin 2027 parashikohen 1,282,376 mije lek investime kapitale sipas programeve**;**
    a. Planifikim, Administrim Menaxhim 4% te totalit
    b. Rrjeti rrugor Rural 49% te totalit
    c. Programe Kulturore dhe sporti 34% te totalit
    d. Arsimi Parauniversitar 7% te totalit
    e. Sherbimet publike 3% te totalit

Ne tabelen e meposhtme pasqyrohen **investimet kapitale per vitet 2027-2029;**

Tab nr.3 Investimet kapitale per vitet 2027-2029

Programi	Emri i Programit	Emri i Projektit	2026	2027	2028	2029
			Plani	Plani	Plani	Plani
1110	Planifikim, Administrim Menaxhim	Investime me fonde te brendshme	11,090	23,096	250,100	268,639
		Ndertim zyrash per NSHP ne Volloder	42,170	5,910		
	Total 1110		53,260	29,006	250,100	268,639
3280	Sherbimi zjarrfikes	Investime me fonde te brendshme	-	9,638	9,638	
	Total 3280		-	9,638	9,638	9,638
4520	Rrjeti rrugor Rural	Ndertim trotuare , rikualifikim i rrethimeve anesore ne rruget e brendshme dhe rikualifikim hapsirave shplodhese Ksamil	84,910	5,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikimi I rrugeve te brendshme dhe shesheve Gjashte , Metoq	29,920	20,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim i rrugeve te brendshme zona Turizem -Kanali Çukes Faza I	19,850	20,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim trotuari , K.U.B.- se, ndricim dhe shtresave rrugore ne rruget ``Onhezmi`` dhe ``Lefter Talo``	90,160	40,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim i rrugeve te brendshme ne Lagjen ``Lugu i Dardhes``	14,920	10,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikimi i rrugeve te brendshme dhe shesheve Berdenesh	18,359	11,561		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim I hapsirave te brendshme ne bllok banimi ne lagjen nr.4	30,090	20,000		

4520	Rrjeti rrugor Rural	Ndertim pedonale segmenti rrugeve ``DEA - ISADORA DUNKAN - ALIDA HYSKU`` , Ksamil	50,090	30,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Riveshje shtresa asfaltike ne territorin e Bashkise	11,000	7,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Shkallare lidhese lagj nr 3 dhe rikualifikim shkallare prane Portit	12,000	10,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim i rruges Rilindja Sarande	40,000	30,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Investime ne infrastrukturen rrugore	550,312	627,364	785,045	769,319
	Total 4520		951,611	830,925	785,045	769,319
6260	Sherbime publike Vendore	Investime me fonde te brendshme	27,260	27,260	27,260	27,260
	Total 6260		27,260	27,260	27,260	27,260
6370	Furnizimi me ujë,KUZ.	Furniz.me ujë zona periferike L.Dardhë&B.Rexhepi				
6370	Furnizimi me ujë,KUZ.	Investime me fonde te brendshme	11,780	11,780	11,780	11,780
	Total 6370		11,780	11,780	11,780	11,780
8130	Programe Kulturore	Investime me fonde te brendshme	6,000	-	130,000	130,000
8130	Programe Kulturore	Rikonstruksioni I Kinoteatrit	30,090	270,000		
	Total 8130		36,090	270,000	130,000	130,000
9120	Arsimi Parauniversitar	Investime ne terrene sportive ne shkolla	10,000	20,090	54,135	
9120	Arsimi Parauniversitar	Rikonstruksion kopeshti 2 dhe 3	20,080	41,170		
9120	Arsimi Parauniversitar	Rikonstruksion Shkollat 9 vjecare Cuke	10,000	18,916		
9120	Arsimi Parauniversitar	Rikonstruksion Kopeshte dhe Shkolla ne Metoq, Shelegar, Berdenesh	10,080	21,604		
9120	Arsimi Parauniversitar	‘‘Rindertimi i shkolles 9 vjecare „Baba Rexhepi“ Sarande“	6,709	15,000	14,089	
	Total 9120		50,160	103,767	54,135	52,950
	TOTALI	Te ardhurat e veta	1,130,161	1,282,376	1,267,958	1,269,586

Tab nr.2 Tavanet e Shpenzimeve e Bashkise Sarande sipas programit dhe klasifikimit ekonomik 2027-2029

Kod Programi	Funksionet	Fakt 2025			Plan 2026				Plan 2027				Plan 2028				Plan 2029			
		Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve	Shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve	Shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve
1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	168,146	-	382,189	248,462	237,428	53,260	539,150	264,327	242,177	29,006	535,510	264,327	247,020	250,100	761,447	266,970	247,020	268,639	782,629
3280	Shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit	4,261		27,919	27,655	3,270		30,925	26,590	3,335	9,638	39,563	26,590	3,402	9,638	39,630	26,856	3,402	9,638	39,896
4240	Ujitja dhe kullimi,bujqesia	2,000	8,723	12,822	2,567	5,291		7,858	2,707	5,397	-	8,104	2,707	5,505	-	8,212	2,734	5,505	-	8,239
4260	Administrimi Pyjeve			3,152	3,618	164		3,782	3,828	167	-	3,995	3,828	171	-	3,999	3,866	171	-	4,037
4520	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor		313,070	313,070	-		951,611	951,611	-	-	830,925	830,925	-	-	785,045	785,045	-	-	769,319	769,319
5100	Menaxhimi I Mbetjeve	193,471		193,471	-	201,024	-	201,024	-	205,044	-	205,044	-	205,044	-	205,044	-	205,044	-	205,044
6260	Sherbime Publike Vendore	36,525	12,240	142,022	134,080	55,580	27,260	216,920	142,342	56,692	27,260	226,294	142,342	57,825	27,260	227,427	143,765	57,825	27,260	228,851
6370	Ujesjelles, Kanalizime			-	-		11,780	11,780	-	-	11,780	11,780	-	-	11,780	11,780	-	-	11,780	11,780
8130	Programe Kulturale & Sporti	7,648		36,448	34,213	8,980	36,090	79,283	36,243	9,160	270,000	315,403	36,243	9,343	130,000	175,586	36,605	9,343	130,000	175,948
9120	Arsimi parashkollor	22,716		127,509	137,059	30,490	50,160	217,709	129,984	31,100	103,767	264,851	129,984	31,722	54,135	215,841	131,284	31,722	52,950	215,956
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	657		3,663	4,434	2,833	-	7,267	4,434	2,890	-	7,324	4,434	2,947	-	7,381	4,478	2,947	-	7,426
9230	Arsimi i mesem profesional	1,949		12,164	10,573	10,324	-	20,897	12,800	9,143	-	21,943	12,800	9,326	-	22,126	12,928	9,326	-	22,254
10430	Shërbimi Social t'ardh veta	663		4,068	3,443	1,700		5,143	3,943	1,734	-	5,677	3,943	1,769	-	5,712	3,982	1,769	-	5,751
Totali		438,036	334,033	1,258,497	606,104	557,084	1,130,161	2,293,349	627,198	566,838	1,282,376	2,476,412	627,198	574,074	1,267,958	2,469,230	633,470	574,074	1,269,586	2,477,130

Burimet njerezore

Pjesë e rëndësishme e programit afatmesëm 2027-2029, është edhe numri i punonjësve të administratës, të njësive shpenzuese në varësi dhe i funksioneve specifike.
Burimet njerezore jane aseti me i rendesishem ne veprimtarine e Bashkise prandaj vemendje te vecante merr parashikimi i fondeve per pagat, trajnimin e tyre , kualifikimet e nevojshme, dhe ne sektoret qe ka nevoje per shtese te numrit te punonjesve te realizohen. Kjo ben qe funksionet e sektoreve te vecante por edhe ne teresine e funksionimit te pushtetit vendor te behet me efektiv dhe cilesisht i rritur. Pushteti vendor per burimet njerezore ka si synim reaizimin e objektivave te meposhtme:

a) Rritjen e efiçencës dhe e performancës së strukturave organizative.
b) Përmirësimin e proçedurave dhe respektimin e afateve proceduriale per punonjesit.
c) Përmirësimin e shërbimit per qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
d) Koordinimin e administrimit territorial.
e) Realizimin e plotë të objektivave.

Në strukturen organike te Bashkisë së Sarandes perfshire edhe njesite e varesise dhe Njësine Administrative parashikohen të shtohen në total 6 punonjës ne periudhen afat mesme 2025-2027.
Rritja eshte parashikuar ne sektorin e Sherbimeve Publike, dhe ne sektorin e Arsimin parashkollor.
Për sa më sipër, për mbarëvajtjen e kërkesave dhe funksioneve të shtuara në të gjitha drejtoritë, për burime njerëzore, për përpunimin e të dhënave dhe treguesve statistikore për personel të kualifikuar në sektorin e sherbimit dhe sektoreve te tjere publike, si rezultat i sektoreve të shtuara të punës , ne vazhdimesi evidentohet domosdoshmëria e riorganizimit të punës e pasqyruar kjo edhe ne strukturen organike te Bashkise.

Numri i Punonjesve sipas programeve buxhetore per periudhen 2027-2029

Ndryshimi i numrit te punonjesve ne periudhen afatmesme					
Emërtimi Programit	Parash. F. 2025	Parash. V. 2026	Parash. V. 2027	Parash. V. 2028	Parash. V. 2029
Punonj adminis qëndrore e të njësive në varësi	334	354	354	354	354
Punonjës të funksioneve specifike	126	126	126	126	126
TOTALI	460	480	480	480	480

PBA 2027-2029 per perkrahjen sociale dhe Barazine Gjinore .

Buxhetimi per Barazine Gjinore eshte nje qasje e menaxhimit te financave publike qe synon te integroje nje prespektive gjinorene planifikim si edhe monitorimin e buxheteve publike. Kjo qasje siguron qe burimet financiare te shperndahen ne menyre te drejte per grate dhe burrat duke marre parasysh sfidat dhe nevojat e tyre specifike.

Qellimet kryesore te buxhetimit gjinor ;

1. Reduktimi i pabarazise gjinore- Adresimi i hendekut ekonomik social dhe politik ndermjet burrave dhe grave.
2. Shperndarja e drejte e burimeve – Sigurimi qe sherbimet publike dhe programet sociale u sherbejne ne menyre te barabarte te gjithe qytetareve, pavaresisht gjinise.
3. Fuqizimi ekonomik i grave- Mbeshtetja e grave ne sektore te ndryshem permes financimeve, investimeve dhe politikave te favorshme.

Buxhetimi gjinor behet nepermjet;

- Financimi i programeve per fuqizimin ekonomik te grave.
- Mbeshtetje dhe kujdes ndaj femijeve per te lehtesuar punesimin e grave.
- Investime per arsimin per te siguruar qasje te barabarte per vajzat dhe djemte.
- Politika te mbeeshtetjes per grate ne bujqesi,sipermarrje dhe sektore te tjere te ekonomise.

Buxhetimi per barazine gjinore nuk ka per synim krijimine buxheteve te ndara per burrat dhe grate, por perdorimi i burimeve ne menyre te tille qe te promovohet barazia dhe te eleminohen diskriminimet ekzistuese.

Tavanet dhe nivelet orjentuese, të pasqyruara në programin e paraqitur, janë përgjithësisht detyruese. Ato do shërbejnë si bazë referuese për përgatitjen e kërkesave dhe të kuotave të Programit Buxhetor Afatmesem 2027-2029 si dhe të përgatitjes së buxhetit vjetor 2027.
Projekti Buxhetor Afatmesem, do të diskutohet me, komunitetin vendor dhe grupet e interesit, për të mundësuar, hartimin e PBA sa më gjitheperfshires dhe transparent per fazen e dyte edhe ate perfundimtre te procesit te hartimit te PBA 2027-2029.